



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE

Procesverbal për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës së prokurimit në lote me objekt “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve specifike”

I mbajtur sot në datë 20.02.2023 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve specifike”, me fondin limit **46 666 658** (*dyzet e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë*) **lekë pa tvsh.**

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur.** Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

Së pari, kemi të bëjmë me 1 (një) lloj shërbimi referuar preventivit të parashikuar, i destinuar për objekte të paracaktuara ku shërbimet janë të kufizuara në kohë Brenda afatit 1 Qershor 2023 deri më 15 Shtator 2023, ku në grafikun e parashikimeve të shërbimeve shpërndarja a fuqisë punëtoren ë të njëjtën kohë në disa objekte do të sillte pamundlsinë e koordinimit të subjekteve të ndryshëm, pra nuk ka asnjë arsye apo shkak për ndarjen e procedurës në lote.

Së dyti, Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin, ndër të tjera, mirëmbajtjen periodike të planifikuar të objekteve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë. Shërbimi i mirëmbajtjes do të realizohet nga kontraktuesi nën monitorimin e autoritetit kontraktor direkt në objektet arsimore sipas planit të hartuar nga autoriteti kontraktor në çdo kontratë.

Në këto kushte, krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa operatorë ekonomikë, ku AK-së do t'i duhet të presë shërbimin për disa zëra nga njëri operator dhe shërbimin për disa zëra të tjerë nga operatori tjetër, sipas loteve, ofron pasiguri, konfuzion, kosto shtesë, vonesa duke vështirësuar në ushtrimin e detyrave të AK-së apo mosrealizim të punëve sipas objektivave.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rëndësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij shërbimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtin shërbim të ngjashëm, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për kryerjen e shërbimeve të parashikuara në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.